



Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika

Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika

ka të  
earch  
vanje  
endra  
tika -  
ka të  
earch  
vanje  
endra

## POLICIA KOMUNALE E PRISHTINËS:

*Mandati, qëllimi, përgjegjësitë dhe mbikëqyrja*

### Propozim i konceptit ideor

www.sprc-ks.org  
Shtator 2017, Prishtinë

Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika - Security Policy Research Center – SPRC - Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë - Centar za istraživanje bezbednosnih politika

**Publikues:**

Security Policy Research Center – SPRC

**Autorë:**

Burim Ramadani  
Rifat Marmullaku

**Asistent/Hulumtues:**

Tahir Ahmeti

Shtator 2017, Prishtinë

---

| 2

Teksti original është shkruar në gjuhën shqipe

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga Security Policy Research Center. Të drejtat e pronës intelektuale janë të mbrojtura me Ligjin Nr. 04.L-065 për të drejtat e autorit dh të drejtat e përafërta dhe Ligjin Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet në çdo formë ose me çdo mjet, elektronik, mekanik apo ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.



Security Policy Research Center  
Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë  
Centar za istraživanje bezbednosnih politika  
www.sprc-ks.org, info@sprc-ks.org, Ulpiana, D9, H-6, No:6, 10000 Prishtina

---

# POLICIA KOMUNALE E PRISHTINËS:

## *Mandati, qëllimi, përgjegjësitë dhe mbikëqyrja*

| 3

### Propozim i konceptit ideor

#### **PUBLIKIM I VEÇANTË**

Autorë:  
Burim Ramadani *dhe* Rifat Marmullaku

Prishtinë  
Shtator 2017

## **Përmbajtja:**

|   |       |
|---|-------|
| 1. Hyrje .....  | 5     |
| 2. Përmbledhje Ekzekutive .....   | 6     |
| 3. Policia Komunale e Prishtinës .....  | 7     |
| 3.1 Mandati .....   | 7     |
| 3.2 Detyrat .....   | 7     |
| 4. Qeveria dhe Mbikëqyrja e Policisë Komunale të Prishtinës .....                             | 8   4 |
| 4.1_Qeverisja e Policisë Komunale të Prishtinës .....   | 8     |
| 4.2 Mbikëqyrja e Policisë Komunale të Prishtinës .....  | 9     |
| 5. Ndërlidhja me Policinë e Kosovës .....   | 9     |
| 6. Hapat e mëtejshëm institucionalë rreth Konceptit për Policinë Komunale të Prishtinës ..... | 10    |

## 1. Hyrje

Nevoja për të themeluar Policinë Komunale të Prishtinës është artikuluar për vite me radhë, përkatësisht për më shumë se një dekadë. Qysh në vitet e para-shpalljes së pavarësisë së Kosovës, organet komunale të Prishtinës kanë shprehur publikisht vlerësimin për ndihmesën që Prishtinës do t'i bënte ekzistimi i Policisë Komunale.

A duhet të ketë Prishtina një mekanizëm zbatues për vendimet e veta nën juridiksionin komunal? Çka do të ndihmonte Komunën e Prishtinës për zbatimin më efektiv dhe më autentik të vendimeve të veta?

Këto dhe pyetje të tjera, sigurisht, janë shtruar disa herë në opinionin publik në Kosovë, derisa përgjegjësinë për ndihmesën në zbatimin e vendimeve komunale sërish e luan Policia e Kosovës.

Porse, sigurisht, pyetjet kryesore mbeten të ndërlydhura me konceptin bazik mbi atë se:

1. Çka paraqet një mekanizëm i tillë si Policia Komunale e Prishtinës?
2. Çfarë mandati, përgjegjësisë dhe autorizimesh do të kishte Policia Komunale e Prishtinës?
3. Si do të funksiononte Policia Komunale e Prishtinës?
4. Kush dhe si do të realizohej Mbikëqyrja Demokratike e Policisë Komunale të Prishtinës?
5. Çfarë kapacitete, pajisje dhe trajnime do të duhej të kishte Policia Komunale e Prishtinës?
6. Cilat do të ishin ndryshimet ligjore të domosdoshme?
7. Si do të ndërvepronte me Policinë e Kosovës dhe autoritetet qendrore?

## 2. Përmbledhje Ekzekutive

Duke u bazuar në përgjegjësinë dhe mandatin e Policisë së Kosovës dhe njëkohësisht ngarkesës së madhe me detyra në baza ditore që nuk përkojnë me mandatin e saj, Policia e Kosovës përballet me domosdoshmërinë e alokimit të personelit të saj dhe shfrytëzim joprimar policor të burimeve të saja.

Si pasojë, Policia e Kosovës ndodh që të përballet me mungesë të burimeve të mjaftueshme njerëzore për të kryer detyrat e saja primare në funksion të zbatimit të rendit dhe ligjit, parandalimit dhe luftimit të krimit të të gjitha natyrave.

Pavarësisht mbingarkesës dhe detyrave të natyrës së ofrimit të asistencave të ndryshme për mekanizmat Komunalë, Policia e Kosovës duhet të jetë në gjendje t'u përgjigjet me kohë kërkesave dhe thirrjeve të qytetarëve. Sipas standardeve Perëndimore, ofrimi i shërbimit në vend të ngjarjes për fusha të caktuara është i matshëm edhe në aspektin e shpejtësisë, prandaj mbingarkesa e Policisë së Kosovës në punët e ndërlidhura me juridiksionin komunal në Prishtinë pengon në masë të madhe arritjen e këtij standardi.

Kjo mund të reflektohet edhe përmes ankesave të qytetarëve deri tek shprehjet e pakënaqësive, pavarësisht se qytetarët nuk janë të njoftuar me volumin e madh të punëve që Policia e Kosovës kryen dhe që kanë të bëjnë me fushat nën juridiksionin komunal, në këtë rast të Prishtinës.

## 3. Policia Komunale e Prishtinës

### 3.1 Mandati

Policia komunale është organ ekzekutiv i Komunës së Prishtinës, që ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit e të qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit dhe juridiksionit të Komunës, që nuk janë në kompetencë të autoriteteve të tjera shtetërore.

### 3.2 Detyrat

Policia Komunale e Prishtinës detyrë primare do të ketë ruajtjen dhe mbrojtjen e rendit publik dhe zbatimit të aktiviteteve nën juridiksionin e komunës së Prishtinës, por nuk do të kufizohet në:

- Zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal, e që kanë të bëjnë me sigurimin e rendit e të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike.
- Të marrë masa për ruajtjen e pasurisë të komunës, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.
- Të sigurojë zbatimin e urdhërave të nxjerra nga Kryetari i Komunës në lidhje me personat juridik e fizikë, që nuk plotësojnë konform ligjit detyrimet financiare e fiskale ndaj Komunës, si dhe çdo detyrim tjetër pasuror ndaj tyre.
- Reagimin në rastet e shkeljeve ligjore për zënien e hapësirave publike apo tregti e paligjshme (ambulantë), vendosjen e reklamave, tendave, dëmtimin e sipërfaqeve të gjelbra, trotuareve, ndriçimit publik, ndotjen e mjedisit etj, si dhe ndëshkimin e kundërvajtësve me gjobë.
- Në parandalimin, pezullimin dhe prishjen e ndërtimeve pa leje.

- Të mbështesë Inspektoratin në zbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje, objekte që kanë penguar punimet në infrastrukturën rrugore.
- Lirimin e objekteve që janë pronë e komunës, kopshte, biblioteka, ish-ndërmarrje etj. të zëna nga persona të ndryshëm në mënyrë abuzive.
- Konstatimin dhe ndëshkimin e shkeljeve në drejtimin dhe parkimim e automjeteve që nuk respektojnë kërkesat e ligjit për rregullimin e trafikut.
- Ndalimin e shitjes në rrugë dhe lëmoshë-kërkuesve.
- Të mbikëqyrë respektimin e orarit të punës të objekteve hoteliere dhe objekteve të tjera që mund të prishin qetësinë e qytetarëve.
- Të kontrollojë nëse qytetarët bëjnë pastrimin e dëborës dhe akullit para shtëpive të tyre, ndërtesave dhe hapësirë komerciale.


## 4. Qeveria dhe Mbikëqyrja e Policisë Komunale të Prishtinës

### 4.1 Qeverisja e Policisë Komunale të Prishtinës

| 8

Qeverisja Demokratike e Policisë Komunale të Prishtinës duhet të bazohet në vlerat dhe normat kushtetuese e ligjore në Kosovës, sikurse edhe në standardet më të avancuara të qeverisjes demokratike në sektorin e sigurisë.

Përgjegjësitë kryesore për udhëheqjen institucionale të Policisë Komunale të Prishtinës fokusohen te Kryetari-Kryetarja e Komunës së Prishtinës, i-e cila themelon Drejtorinë Komunale të Rendit Publik dhe emëron udhëheqësin e kësaj Drejtorie.






## 4.2 Mbikëqyrja e Policisë Komunale të Prishtinës

Policia Komunale e Prishtinës duhet të ketë mbikëqyrje demokratike dhe të jetë transparente dhe llogaridhënëse.

Asambleja Komunale duhet të themelojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Drejtorisë Komunale të Rendit Publik, duke arritur të mbikëqyrë edhe në aspektin e politikave, edhe të menaxhimit dhe administrimit, edhe të aspektit financiar, edhe të aspektit të ligjshmërisë së aktiviteteve.

Policia Komunale dhe Drejtoria Komunale e Rendit Publik duhet të jetë e hapur dhe shprehmisht e përcaktuar në Ligj, për mbikëqyrje publike, nga mediat, shoqëria civile, Auditori i brendshëm dhe Gjeneral, sikurse edhe nga Ombudspersoni.



## 5. Ndërlidhja me Policinë e Kosovës

Policia Komunale e Prishtinës duhet të ketë ndërlidhje partneriteti me Policinë e Kosovës. Kjo duhet të precizohet në Ligjin për Policinë Komunale të Prishtinës, Ligjin për Prishtinën dhe në Ligjin për Policinë e Kosovës.

Ndërlidhja mes këtyre dy institucioneve (lokal dhe qendror) duhet të jetë funksionale dhe e ofrimit të mbështetjeje së dyanshme. Më konkretisht, në rastet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe autorizimet në fushat e sakta në të cilat ushtrojnë autoritetin e tyre.

## 6. Hapat e mëtejshëm institucionale rreth Konceptit për Policinë Komunale të Prishtinës

Themelimi i Policisë Komunale të Prishtinës duhet të kalojë një proces të gjerë të konsultimeve dhe analizimeve të sakta dhe gjithëpërfshirëse:

1. Të formohet një Ekip Profesional Qendror-Lokal për përgatitjen e konceptit më të gjerë dhe Planit të Veprimit për themelimin e Policisë Komunale të Prishtinës;
2. Një vlerësim gjithëpërfshirës (studim) i mundësive dhe nevojave të sakta për komunën e Prishtinës dhe autoritetet qendrore;
3. Gjetjet dhe rekomandimet e dala nga ky vlerësim gjithëpërfshirës të analizohen në aspektin funksional dhe atë buxhetor;
4. Të analizohet aspekti ligjor dhe ndryshimeve ligjore të domosdoshme;
5. Të nxjerret Ligji për Policinë Komunale të Prishtinës;
6. Të ndryshohet ligji për Armët;
7. Të definohet pakoja e trajnimeve, armëmbajtja për PKP-në dhe periudha kohore e vlerësimit të funksionimit.

